

Dr. Vjollca Vladi, Mban pozicionin e Drejtorit të Departamentit të Mbrojtjes së Bimëve pranë Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë.

Është diplomuar në Universitetin e Tiranës, Fakulteti I shkencave të Natyrës, profili shkencat Biokimike (1996-2000),

Diplomë e dytë **Master Shkencor** në Universitetin Bujqësor të Tiranës, Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit mbi Analizën Kimike në Shkencat e Prodhimit Bimor (2003– 2005).

Ka marrë titullin **Doktor i Shkencave (PhD)** pranë Universitetit Bujqësor të Tiranës, Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit (2010 – 2015).

Znj. Vladi ka kryer nje sërë kualifikimesh dhe trajnimesh jashtë vendit mbi fushën që mbulon.

Aftësi profesionale kryesore:

Kimi analitike, kontrolli i cilësisë, prokurimi i pajisjeve analitike.

- **Eksperiencë 21 vjeçare** në marrjen e mostrave, përgatitjen, ekstraktim dhe analizën kimike të matricave të ndryshme si uji, toka dhe ushqimi. Përvojë e gjerë duke punuar me metoda ISO, CIPAC, AOAC etj.
- **14 vite eksperiencë** në analizimin e pesticideve (formulimet dhe mbetjet), nitratet/nitritet dhe ndotësit në produktet ushqimore.
- **Eksperte në njohjen e** instrumenteve analitike bashkëkohore me theks të veçantë në teknikat kromatografike të masës. HPLC > LCMS > **LC/MS-MS** > GC-FID/ECD/NPD > Sistemet GC-/MS dhe **GC-MS/MS**. Mirëmbajtje dhe zgjidhje e problemeve.

Njohuri të shkëlqyera të aplikimit të sistemeve të sigurimit të cilësisë, trajnimit dhe vlerësimit të metodave analitike

- **14 vjet eksperiencë në aplikimin e sistemeve të sigurimit të cilësisë**, duke përfshirë projektimin e POS-ve (Procedura Standarde Operative), trajnimin e stafit në përdorimin e POS-ve, mbikëqyrjen dhe vlerësimi i metodave analitike për të përmbushur kërkesat e ISO 17025:2017 dhe GLP.
- **Ekspertizë në zhvillimin, dizajnimin dhe vlefshmërinë e metodave analitike** (përdorimi i kontrolleve të blank/spike, kufijtë e zbulimit, kufijtë e kuantifikimit, saktësia, perpikmeria etj).

Përvojë në shtrirjen e aftësive laboratorike analitike për laboratorët rajonalë.

- **Trajnues dhe vlerësues i specialistëve dhe teknikave** të analizave kimike nga laboratorët rajonalë në Shqipëri. Kjo përfshin hartimin dhe dhënien e mësimëve teorike, kurset e trajnimit në laborator dhe vlerësimet.
- **Pedagog i ftuar në Universitetin Bujqësor të Tiranës, Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit në modulin** : “Biokimi e Pesticideve” dhe “Biokimi e Përgjithshme” (2008-2023).

Znj Vladi ka gjithashtu nje numer te madh Botimesh Shkencore ne konferenca dhe revista nderkombetare.